



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2018:064473

Datë: 07.05.2019

Numri i dokumentit: 00301485

**P. nr.740/18**

### NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË-Departamenti i Përgjithshëm**, Gjyqtarja **Ilirjana Hoti**, me sekretaren juridike Flutur Nagavci, në çështjen penale kundër të akuzuarës **D. D.nga Gjakova**, për shkak të veprës penale të vjedhjes së shërbimeve komunale nga neni 320 të KPRK-së, sipas Aktakuzës të Prokurorisë Themelore-DP në Gjakovë, PP.nr. 1480/18 të dt.16.10.2018, në shqyrtimin fillestar të mbajtur më datë **10.04.2019**, në prani të Prokurorit së shtetit Enis Gashi si dhe të akuzuarës, të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli këtë:

### A K T G J Y K I M

E akuzuara **D. D.nga Gjakova, Rr” . . .**, ,e bija e **I. . .** dhe e nënës **E. e gjinisë M. . .**, data e lindjes . . . ,shkollën e mesme , shitëse , e gjendjes se dobët ekonomike , shqiptare ,shtetase e R. Kosovës ,e martuar ,nënë e 2 fëmijëve, me nr. ID . . .

### Ë s h t ë f a j t o r e

#### Sepse :

**-ndërmjet datës së pavërtetuar e gjerë me datë 22.08.2017**, në lokalit e saj në Rr.”. . .”, me qëllim që vetes t’i sjell përfitim pasuror, në mënyrë të kundërligjshme, në kundërshtimi me dispozitën e nenit 39 te Ligjit për Energji Elektrike të Republikës se Kosovës, ka shfrytëzuar rrem elektrike në atë mënyrë që pas kontrollit është konstatuar se e pandehura ka anashkaluar njehsorin me nr. . . .,përmes kabllor 3x2.5 mm., në mënyrë ilegale është lidhur direkt në rrjetin elektrik ,me këtë veprim energjia elektrike nuk është regjistruar, ç ‘rast ndërmarrjes së dëmtuar **K. . .**, i ka shkaktuar dëme materiale në shumën prej 766.32 euro.

**-me çka ka kryer veprën penale të vjedhjes së shërbimeve komunale nga neni 320 të KPRK-së**

Andaj Gjykata në bazë te nenit 4,17,41,46,49,50,51,52 par 5 ,73 ,neni 320 të KPRK-së dhe nenit 365 të KPP, të akuzuarës i shqipton :

### DËNIM ME KUSHT

Dënim me burgim në kohëzgjatje **prej 3(tre) muajve** dhe dënim me gjobë ne shumë **prej 200 €(dyqind euro)**, të cilat dënime nuk do të ekzekutohet nëse e akuzuara brenda kohës se verifikimit ne afatin prej 1 (një) viti, nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale.

Detyrohet e akuzuara që ti paguaj shpenzimet procedurale te përcaktuara nga ana e gjykatës dhe në emër të paushallit gjyqësor shumë prej nga **20,00-€**, në afat prej **15** ditësh, e krejt këtë pas plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi.

### **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Gjakovë, me aktakuzën PP.nr. 1480/18 të dt.16.10.2018, ka akuzuar të akuzuarën D. D. nga Gjakova, për veprën penale vjedhje e shërbimeve komunale nga neni 320 të KPRK-së.

Prokurori i shtetit Enis Gashi , në shqyrtimin fillestar me dt.10.04.2019, lexoi aktakuzën PP.nr. 1480/18 të dt.16.10.2018, me ç’ rast deklaroi se mbetet në tërësi pranë aktakuzës, por në rreshtin e pare të dispozitivit të aktakuzës duhet te jete në lokalin e saj në rrugën “. . .” e jo në shtëpinë e saj ,ndërsa pjesa tjetër mbetet e pandryshuar.

E akuzuara D. D., gjatë shqyrtimin fillestar duke u deklaruar lidhur me fajësinë thekson se e pranon në tërësi fajësinë sipas aktakuzës me te cilën pandehet duke i ditur edhe më parë pasojat e pranimi të fajësisë dhe atë në mënyrë vullnetare dhe pa presion, me qene se një gjë e tillë është konstatuar nga ana e K.-it e qe ky konstatim ka qene n e lokalin tim ushqimor ne rrugën “. . .” ne Gjakovë , premtojë se një veprim i tillë nuk dot e përsëritet dhe do të jem me e kujdesshme , menjëherë pas njoftimit lidhur me këtë rast kam bërë kompensimin e demit në tërësi me këste sipas marrëveshjes me K.-in ku edhe prezantoj dëftesat e pagesës se rikthimit t humbjeve ,andaj gjykatës i propozojë qe te merr parasysh rrethanat lehtësuese si pranimi i fajësisë ,gjendjen e dobët ekonomike- pagesa ne tërësi e demit ne emër te rikthimit te humbjeve , si dhe faktin se është hera e pare qe kam ra ndesh me ligjin te me shqiptojë një dënim me te butë.

Duke u deklaruar lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit Prokurori i shtetit Enis Gashi, deklaroi se nuk e kundërshton pranimin e fajësisë pasi qe e njëjta është e vetëdijshme për pasojat dhe favorët juridike te pranimi të fajësisë dhe se aktakuza ka mbështetje ligjore dhe prova te mjaftueshme

Në shqyrtimin fillestar gjykata ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

Në tërësi u vërtetua se e akuzuara D. D.: -ndërmjet datës së pavërtetuar e gjerë me datë 22.08.2017, në lokalin e saj ne Rr” . . .” , me qëllim që vetes t’i sjell përfitim pasuror, në mënyrë të kundërligjshme, në kundërshtimi me dispozitën e nenit 39 te Ligjit për Energji Elektrike të Republikës se Kosovës, ka shfrytëzuar rrem elektrike në atë mënyrë që pas kontrollit është konstatuar se e pandehura ka anashkaluar njehsorin me nr. . . .,përmes kabllos 3x2.5 mm., në mënyrë ilegale është lidhur direkt në rrjetin elektrik ,me këtë veprim energjia elektrike nuk është regjistruar, ç’ rast ndërmarrjes së dëmtuar K. , i ka shkaktuar dëme materiale në shumë prej 766.32 euro .

Gjykata gjendjen e këtyllë faktike e ka vërtetuar nga vet pranimi i fajësisë nga e akuzuara e cila në shqyrtimin fillestar vullnetarisht ka pranuar fajësinë, për shkak të së cilës gjykata nuk ka administruar provat. Gjykata ka ardhur në përfundim se pranimi i fajësisë nga e akuzuara është bërë në pajtim me nenin 248 te KPPK-së. Gjatë pranimi të fajësisë gjyqtari i vetëm gjykues konstatojë se e akuzuara ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajësisë, pranimi është bërë vullnetarisht nga e akuzuara, pranimi i fajësisë mbështetet në faktet dhe provat qe i përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit dhe çdo provë tjetër dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje te qartë ligjore ose gabime faktike.

Gjykata nga të cekurat më lartë ka ardhur në përfundim se në veprimet e të akuzuarit formohen të gjitha elementet e veprës penale të përshkruara si në dispozitiv të këtij aktgjykimi dhe për këtë ka vendosur që të akuzuarën ta shpallë fajtores dhe ta gjykojë në bazë të ligjit, më parë duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të saj.

Me rastin e matjes së dënimit, gjykata ka pasur parasysh të gjitha rrethanat nga neni 73 të KPRK-së, të cilat ndikojnë në zbutjen apo ashpërsimin e dënimit. Rrethana rënduese nuk gjeti ndërsa si rrethana lehtësuese gjykata ka vlerësuar personalitetin e të akuzuarës se është nënë e 2 fëmijëve, pranimin e vullnetshëm të fajësisë nga e akuzuara, sjelljen korrekte të akuzuarës në gjykim, premtimin se në të ardhmen nuk do të kryej veprat e tilla, gjendjen e dobët ekonomike, pagesën e dëmit në tërësi të dëmtuarës, si dhe faktin se më parë nuk ka rënë ndesh me ligjin, të cilat rrethana ndikuan që Gjykata ti zbatoi dispozitat e zbutjes së dënimit të parapara me nenin 75 të KPRK-së. Gjykata të akuzuarës i shqiptoi dënim me burg në kohëzgjatje prej 3 (tre) muajve dhe dënim me gjobë në shumë prej 200 € (dyqind euro), të i cilat dënime nuk do të ekzekutohen nëse e akuzuara brenda kohës së verifikimit në afatin prej 1 (një) viti nuk kryen ndonjë veprë tjetër penale me bindje se edhe me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit të parapara nga neni 41 dhe 50 të KPRK-së dhe ky dënim i tillë i shqiptuar sipas bindjes së gjykatës është në proporcion me veprën penale të kryer dhe me rrethanat personale të cilat i posedon e akuzuara.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushalli gjyqësor bazohet në dispozitat e nenit 450 par.1 dhe 2 nën paragrafi 2.6 të KPPK-së.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi .

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË,  
P. nr.740/18 më datë 10.04.2019.**

**Sekretarja juridike,  
Flutur Nagavci**

**Gj y q t a r j a,  
Ilirjana Hoti**

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij Aktgjykimi mund të paraqitet ankesë ,në afatin prej **15 ditësh**, nga dita e marrjes së tij në dorëzim, Gjykatës së Apelit në Prishtinë. Ankesë në kopje të mjaftueshme i dorëzohet kësaj Gjykate.